

Tiranë, më 26.05.2021

NOTE INFORMUESE

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit K.S.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, më 24.02.2021, ndryshoi objektin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit K.S., hetim i nisur nga KLD më 17.01.2018. Në përfundim të hetimit, ILD identifikoi shkelje disiplinore të lidhura me kryerjen e një krimi, sipas nenit 140, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës dhe nenit 104, pika 3 të ligjit nr. 96/2016.

K.S. është deklaruar fajtor për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, sipas nenit 319/ç të Kodit Penal, me vendimin nr. 69, datë 29.10.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, i lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit me vendimin nr. 19, datë 21.09.2020. Ai ndodhet i pezulluar nga detyra që prej vendimit nr. 23, datë 09.02.2018 të KLD-së.

Ndërkohë, më 18.01.2021, K.S. paraqiti kërkesë për dorëheqje nga detyra dhe mbarimin e statusit të magjistratit. Megjithatë, sipas nenit 134, pika 1, shkronja “ç” të ligjit nr. 96/2016, dorëheqja nuk përbën shkak për mbylljen e hetimit disiplinor. Për këtë arsye, KLGJ, me vendimin nr. 69, datë 01.03.2021, pezulloi shqyrtimin e dorëheqjes deri në përfundimin e hetimit disiplinor. Si rrjedhojë, K.S. vijon të gëzojë statusin e magjistratit dhe mbetet subjekt i hetimit disiplinor.

Në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor si dhe të pranuar nga gjykata rezulton se:

- Nga ana e magjistratit janë ndërmarrë veprime aktive me anë të përfitimit në mënyrë të drejtpërdrejtë, veprime të cilat janë vlerësuar se përmbajnë elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 319/ç i K.Penal, të kryera gjatë ushtrimit të detyrës, me dashje direkte dhe me qëllim përfitim të parregullt prej tyre, duke favorizuar njërin palë ndërgjyqëse nëpërmjet dhënies së vendimi gjyqësor civil në favor të tij.
- Veprimet e magjistratit K.S. kanë cenuar veprimtarinë e rregullt të organeve të drejtësisë nga veprimet e parregullta të personave të jashtëm por edhe nga veprimet e vetë atyre si funksionarë të drejtësisë.
- Këto veprime kanë cenuar besimin e palëve ndërgjyqëse dhe të publikut në organet e drejtësisë dhe respektimin e ligjit nga ana tyre, si dhe kanë diskretituar rëndë pozitën dhe figurën e magjistratit.
- Kur shkelja disiplinore identifikohet me kryerjen e një krimi, për të cilin magjistrati është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, passjell shkarkimin nga detyra të magjistratit, si një masë me natyrë përjashtuese nga sistemi gjyqësor, me karakter të përhershëm, e cila nuk shuhet.

Për pasojë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kërkon nga KLGJ administrimin e provave të paraqitura prej tij në këtë procedim disiplinor, pranimin e kërkesës së ILD për fillimin e procedimit disiplinor dhe caktimin ndaj magjistratit K.S. të masës disiplinore “shkarkim nga detyra”.